

Rregullat e sjelljes para dhe pas një operacioni në KSB

Informacion

Orë bisede-Anestezioni
Telefon +41 56 486 31 46
ipas.chirurgie@ksb.ch

Të dashura paciente dhe pacientë

Ju përmes bashkëveprimit Tuaj mundeni të kontribuoni për atë, të i parandaloni veprimet anësore të pakëndshme apo komplikimet, të cilat janë të mundshme gjatë secilës procedurë anestezioni. Ju lutemi na ndihmoni, të evitojmë raste të padëshiruara, në atë mënyrë që Ju do i respektoni rregullat vijuese të sigurisë:

Esëll, me stomak bosh

Nëse nuk jeni marrë vesh ndryshe, të vlefshme janë rregullat vijuese për të qenë esëll:

Ardhja në ditën e operimit:

- Ushqimet e ngurta janë të lejuara deri 6 orës para hyrjes, pas kësaj jo më.
- Lëngje të tejdrukshme (Ujë me/pa gaz, çaj/kafe i/e ëmbëlsuar pa qumësht/krem) janë të lejuara deri 2 orë para hyrjes, pastaj jo më.
- Përrjashtim bënë: Medikamentet e përshkruara me një gllënjë ujë ja në të lejuar.
- Pasi që mund të ketë vonesa të paparapara në programin e operacionit, ne ju rekomandojmë të pini 2 orë para operacionit një deri dy gota ujë. Kjo e ngrit ndjesinë Tuaj të mirë para dhe pas operacionit.

Ardhja dhe hyrja në ditën para operacionit:

- Ju nuk duheni të vini esëll, nëse nuk është përcaktuar ndryshe.

Medikamentet

- Medikamentet e mëngjesit i merrni, ashtu siç ju ka përshkruar mjeku i anestezionit.
- Nëse në mes të bisedës së anestezionit dhe të terminit të operimit, apo të gjendjes Tuaj shëndetësore, kanë ndodhur ndryshime në medikacionit Tuaj, ju lutemi kontaktoni mjekun e anestezionit nën 056 486 31 44.
- Në ditën e ardhjes dhe hyrjes, ju lutemi sjellni të gjitha medikamentet, të cilat ju duheni ti merrni.

Medikamentet:

Stoli dhe gjëra me vlerë

- Të gjitha copat e stolive dhe të gjësendeve tjera me vlerë dhe të lëvizshme, leni në shtëpi. Spitali KSB nuk japë garanci për gjësendet e humbura.
- Elektronika zbavitëse dhe mjetet e punës e shkurtojnë ditën e qëndrimit në spital, mirëpo ato mund të humbin lehtë. Për këtë vendosni me kujdes të lartë!
- Aparate për luajtje muzike (MP3-Player, Smartphon me modus aeroplani) me vete mund të merren me vete sallë operacioni (OP) në raste të anestezionit. Në rast të humbjes apo dëmtimit do refuzohet çfarëdo garancie.
- Piercings mund të qon deri te djegia. Nëse mund të hiqet, leni në shtëpi. Përndryshe për këtë do ju tërheqin vërejtjen mjeket dhe mjekët. Në rast të djegies apo humbjes do refuzohet çdo lloj garancie.

Ndihmesa shikimi dhe dëgjimi

- Syzat dhe lentat kontakti nuk guxojnë të merren me vete në sallën e operacionit, përveç në raste të çrregullimeve të mëdha të shikimit.
- Aparatet dëgjimi në sallë operimi guxojnë të merren me vete vetëm në raste të narkozës lokale.
- Në rast të humbjes apo dëmtimit do refuzohet çdo lloj garancie.

Higjiena

- Në operacion paraqituni i pastruar (me dush të bërë së bashku me pastrim kërthize), mirëpo **pa grim dhe pa krem trupi/losione trupi**.



8 0 0 0 0 0 4 9 1

Proteza dhëmbësh

- Protezat dhëmbësh apo proteza lokale gjatë operacionit mund të shkoqiten, të shkaktojnë lëndime, të dëmtohen apo të humbasin.
- Për këtë arsye protezat dhëmbësh para operacionit duhet të hiqen dhe të vendosen në një enë speciale të shënuar me emër dhe të lehen në stacion.

Ardhja dhe hyrja në ditën e operacionit, para operimit

- Lajmërohuni në termin të caktuar në sportel për pranim të pacientëve -«Patientenaufnahme»-. Nga aty Ju në shumicën e rasteve do shoqëroheni deri në stacionin tonë të arritjes -Eintritts-Station SDS (same day surgery)- të trajtimit të asaj dite.
- Personeli kujdestarë do verifikon se a jeni Ju esëll dhe ai i keni marrë medikamentet e nevojshme.
- Ju lutemi ndërroni veshjen para intervenimit të pritur. Sjellja e veshjeve Tuaja dhe të gjësendeve do të kryhet më vonë në stacion në dhomën Tuaj, bagazhi Juaj do jetë tani më aty për Ju.
- Në pikën kohore të caktuar do ju dërgojnë në sallën e operacionit.
- Ju lutemi të vini re, që për shkak të rasteve emergjente apo kohëzgjatjes së operacioneve të mëparshme mund të vjen deri te vonesat. Ne do bëjmë të gjitha të mundur që t'ju informojmë mirë dhe Juve në rast nevojë t'ju mundësojmë një shëtitje në kopshti tonë (Në këtë rast Ju lutemi vini re rregullores për të qenë esëll!).

Pas operacionit

- Pas intervenimit Ju do e kaloni një kohë me mbikëqyrje të shpeshta në dhomën e zgjimit. Kur shtypja e gjakut, frekuenca e zemrës dhe e frymëmarrjes janë stabilizuar dhe dhimbjet janë trajtuar në mënyrë të kënaqshme për Ju, Ju do dërgoheni prapa në stacion.
- Ju lutemi lajmërohuni me kohë nëse Ju vëreni dhimbje apo të përziera. Kjo vlen sikurse për kohën në dhomën e zgjimit ashtu edhe pastaj në sektor/ në ambulantë. Sa më shpejt që ne do njoftohemi për ndjenjat Tuaja, aq më shpejtë do mundemi të reagojmë.
- Për mobilizimin Tuaj të parë ju do keni mbështetjen e një personi kujdestarie. Ju lutemi mos u ngrini vetëm nga shtrati.

Rregullat e sjelljes pas intervenimeve ambulante

- Varësisht prej intervenimit, është e mundur, që Ju në ditën e njëjtë mund të shkoni në shtëpi.
- Intervenimi dhe ndikimet e medikamenteve dhe të mjeteve narkoze, përkohësisht i dobësojnë aftësitë Tuaja të vlerësimit dhe reagimit. Për këtë arsye veçmas duhet të vini re:

- Mjetet Tuaja të motorizuara leni në shtëpi, kurrësi mos drejtoni ndonjë automjet.
- Organizoni marrjen Tuaj nga spitali nga ana e një personi shoqërues të rritur.
- Gjatë 24 orëve vijuese pas lëshimit nga spitali ju nuk guxoni të drejtoni automjete, të punoni me makina të rrezikshme dhe të pini alkool.
- Gjatë 24 orëve pas lëshimit nga spitali mos merrni gjithashtu as vendime të rëndësishme dhe mos jepni nënshkrime me pasoja juridike.
- Përkohësisht hiqni dorë nga sporti dhe ngarkimet e larta fizike.

Po që se në shtëpi vjen deri te paraqitja e problemeve, si p.sh. dhimbje të mëdha, të përziera, ndjenja të këqija me djersitje dhe zbehje, apo Ju keni konstatuar rrjedhje gjaku, atëherë lajmërohuni te mjeku kujdestarë të klinikës përgjegjëse (Kirurgjia, Kirurgjia vaskulare, Ortopedia, Urologjia, Gjinekologjia Kontakti me centralin telefonik 056 486 21 11).

Dhënia e pëlqimit dhe vërtetimi

I/e nënshkruari/a vërteton se rregulloret e lartë shënuara i ka lexuar dhe kuptuar. Për pasojat, të cilat ndodhin si pasojë e mospërfilljes së këtyre rregullave, Kantonsspital Baden AG nuk mund të merret nën përgjegjësi.

Baden,

Data

Nënshkrimi Pacientja/Pacienti apo përfaqësuesi ligjorë